



RREGULLORE
E
PUNES SË KOMITETEVE TË BORDIT TË DREJTORËVE TË TRAINKOS SH.A

FUSHE KOSOVË 2014

RREGULLORJA E PUNËS

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP dhe Statutin e Kompanisë, Bordi i Drejtorëve i HK TRAINKOS SH.A në Mbledhjen Nr. 49 të mbajtur më 23 dhe më 29.12.2014, miraton Rregulloren për punën e Komiteteve të Bordit si më poshtë:

1. Funkzioni i komiteteve

- a) Bordi i drejtorëve në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet e Kompanisë mund të formojë Komitete për ushtrim me më efikas të funksionit të tij.
- b) Komitetet do të mbikëqyrin dhe verifikojnë se biznesi dhe punët e kompanisë kryhen në mënyrë të ligjshme, profesionale me përgjegjësi dhe në interesin ekskluziv të aksionarëve, ashtu siç parashihet në këtë rregullore, me statut dhe me ligj.
- c) Detyrat specifike të Komiteteve përcaktohen me aktin e emërimit.

2. Anëtarët e komiteteve

- (a) Komitetet përbëhen nga së paku tre (3) drejtorë të caktuar nga Bordi dhe zyrtarë të kompanisë apo konsulentë të jashtëm.
- (b) Komiteti ka kryetarin e vet.
- (c) Procesverbali i komiteteve mbahet nga sekretari i kompanisë.

3. Kompensimi

Anëtarët e komiteteve kompensohen në pajtim me dispozitat ligjore, statutin e Kompanisë dhe vendimin e aksionarit për kompensimin e komiteteve.

4. Kompetencat dhe detyrat e komiteteve

Nën përgjegjësinë e vet kolektive komitetet do të:

- (a) Veprojnë në përputhje me statutin dhe aktet tjera të Kompanisë;
- (b) Shqyrtojnë planin afatgjatë strategjik, investues dhe financiar të Kompanisë dhe çdo ndryshim të tij - planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor para se ta marrin miratimin nga Bordi i Drejtorëve si dhe t'i ofrojnë këtij të fundit ndonjë koment apo kundërshtim nëse e shoh të domosdoshme në fushat respektive të komiteteve;

RREGULLORJA E PUNËS

- (c) Shqyrtojnë, para se të miratohen nga Bordi i Drejtorëve, dokumentet që paraqiten për shqyrtim në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- (d) Verifikojnë rregullisht përshtatshmërinë dhe funksionimin e duhur të Kompanisë, duke përfshirë edhe atë financiar, dhe t'i paraqes Bordit të Drejtorëve çdo koment apo sugjerim që e sheh të domosdoshëm;
- (e) Verifikojnë rregullisht përshtatshmërinë dhe funksionimin e duhur të sistemeve dhe procedurave që kanë për synim garantimin se kompania i respekton të gjitha ligjet e aplikueshme në afarizmin dhe punët e saj dhe t'i ofrojë Bordit të Drejtorëve çdo koment apo propozim që e sheh të domosdoshëm;
- (f) Ushtrojnë konfidencialitetin strikt ndaj çdo raportimi joanonim nga të punësuarit në lidhje me denoncimin e ndonjë keqpërdorimi nga ana e drejtorëve, zyrtarëve apo të punësuarëve tjerë të kompanisë, të mbrojnë identitetin e të punësuarve që mund të jenë cak i hakmarrjes dhe, duke iu nënshtruar mbrojtjes së informatave konfidenciale të informojnë shkurtimisht në lidhje me rezultatin e hetimit.

5. Mbledhjet

- (a) Komitetet zakonisht takohen para mbledhjeve të Bordit. Në këto takime mund të shqyrtohen materiali i përgatitur për takimin e Bordit dhe pikat tjera të veçanta nga fushëveprimi i komitetit.
- (b) Komitetet do të takohen në vendin e dhënë në njoftimin me shkrim të mbledhjes, komitetet do të takohen çdo herë që takohet Bordi i Drejtorëve, arsyeshmërisht para mbledhjes së Bordit dhe kurdo që shihet e arsyeshme nga çdo anëtar i komitetit.
- (c) Njoftimi për mbledhjen do të përcaktojë dhe do të dërgohet të paktën një (1) ditë para mbledhjes, materiali mund të dorëzohet i shtypur, apo në mënyrë elektronike me e-mail apo ndonjë mënyrë tjetër që siguron pranim të shpejtë.
- (d) Në mbledhje, secili kryetar i komitetit, duke vepruar arsyeshmërisht dhe në përputhje me ligjin dhe këtë statut, sigurohet për praninë e kuorumit, mbajtjen e procesverbalit, udhëheq debatin dhe shpall rezultatin e votimit. Kryetari, sipas zgjedhjes së tij, mund të ndihmohet nga Sekretari.
- (e) Komiteti do të veprojë me votën pro të dy (2) anëtarëve në detyrë. Anëtarët që mund të kenë abstenuar nga votimi dhe ata që e kanë shpalosur një konflikt interesi nuk do të përfshihen në numërim sa i përket shumicës. Në rast të një barazimi, kryetari ka votën për të vendosur.
- (f) Për çështjet e shqyrtuara komiteti nxjerr konkluzione në formë rekomandimi të cilat i dërgohen Bordit të Drejtorëve për aprovim.

RREGULLORJA E PUNËS

- (g) Sekretari për mbledhjen e Bordit, përmbledh në një raport konciz pikat që janë diskutuar dhe konkluzionet në formë rekomandimi të të gjitha komiteteve. Kryesuesit e komiteteve referojnë para Bordit lidhur me rrjedhen dhe arsyeshmerinë e nxjerrjes së këtyre rekomandimeve.

6. Zbatueshmeria dhe hyrja në fuqi

- a) Rregullorja vlen për të gjitha komitetet e Bordit përveç për Komitetin e Auditimit, puna e të cilit rregullohet me akt të veçantë.
- b) Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas nëshkrimit.


Heset ÇAKOLLI
Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A.